Raport vjetor 2016

QENDRA RINORE ARDHMERIA– KLINË/KOSOVO

1 Janar & 31 Dhjetor 2016

PERGADITUR NGA: VITORE ZEFI

ME 31/12/2016

KLINË

Address: str.Abedin Rexha, 32000 Klinë –Kosovo, tel:+383 (0) 38 748 274,
Web:www.ycardhmeria.com, email: info@ycardhmeria.com, youthcenter.kline@hotmail.com

Hyrje:

Qendra Rinore Ardhmeria është themeluar në vitin 1999, që prej këtij viti qendra organizon aktivitete për të rinjë dhe gjithashtu edhe këtë vit janë implementuar projekte rinore. Në këtë raport janë të përmbledhura të gjitha aktivitetet dhe projektet e realizuara brenda Qendrës Rinore Ardhmeria gjatë vitit kalendarik 2016.

Aktivitetet e qendrës rinore të cilat janë zhvilluar dhe janë të vazhdueshme:

1. KURSET E PËRDITESHME

2. AKTIVITETET DHE INICIATIVAT RINORE

3. BASHKËPUNIMET DHE PARTNERËT

4. STATISTIKAT /PËRFITUESIT

1. KURSET E PËRDITESHME:

1.1 Kursi Gjuhës Angleze

Në mënyrë të rregullt ditore është organizuar kursi i Gjuhës Angleze për fëmijë, të rinjë dhe të rritur. Çdo ditë gjatë këtij viti kanë përfituar shumë pjesëmarrës të cilët kanë ndjekur kursin e Gjuhës Angleze, të rinjët kanë pasur mundësi të marrin pjesë në kursin e organizuar nga lehtësuesi lokal dhe gjithashtu edhe në kursin e edukimit jo-formal nga lehtësuesi evropian. Gjithashtu në tre mujorin e fundit të këtij viti kursi është zhvilluar nga lehtësuesja ndërkombetare.Kursi i Gjuhës Angleze është zhvilluar 3 orë ne javë për secilin grup dhe ka zgjatur 3 muaj një nivel.

1.2 Punëtorit për fëmijë

Gjatë gjithë javës janë zhvilluar puntori të rregullta kreative për fëmijë dhe kemi krijuar një ambient të sigurtë që ata mund të punojnë gjëra të ndryshme nga letrat e përdorura, qeset e plastikes etj. Në mënyrë që fëmijët të edukohen për të mbrojtur ambientin dhe për të kaluar një pjesë të tyre të edukimit në qender rinore. Qëllimi i krijimit të kësaj puntorie dhe ndarja e kohës së veqant për fëmijë është edukimi për mbrojtjen e ambientit dhe reciklimin e mbeturinave nga vetë fëmijët.

1.3 Kursi gjuhës shqipe

Qendra rinore Ardhmeria siguron edhe kursin e gjuhës shqipe për të rinjët evuropian që jetojnë në Klinë për një periudhe të gjatë dhë dëshirojnë të mësojnë shqip, gjatë këtij viti një vullnetar lokal ka mësuar gjuhën shqipe 2 vullnetareve evropiane (Estonis dhe Lituanis). Zhvillimi këtij kursi ka për qëllim integrimin e të rinjëve që vijnë dhe jetojnë në Klinë për një periudhë kohore dhe gjuha shqipe ju mundëson që të adaptohen me lehtë në kulturen tonë kosovare.

2. AKTIVITETET & INICIATIVAT RINORE:

2.1 8-të Vjetori i pavarësisë së Kosovës

Të rinjët e Klinës shënuan ditën e pavarësisë së Kosovës. Për nder të 8-të vjetorit të pavarësisë të rinjët kanë organizuar disa akivitete kreative dhe edukuese për të rinjë në mënyrë që të shenojmë ditën e përvjetorit të pavarësisë së Kosovës.
Të rinjët e moshës 13-15 vjeçë punuan ese duke përshkruar ndjenjen e tyre për pavarësinë e Kosovës, gjithashtu u organizuan workshope dhe këngë shqipe. Gjatë këtij aktiviteti u përzgjedh eseja më e mirë dhe u vlerësua nga dy poetet më të reja të komunës së Klinës. Falendërojmë dy shkollat fillore të qytetit të Klinës për bashkëpunim dhe të rinjët e Klina Youth Chapter për këtë organizim.

17 shkurt 2016, Klinë

2.2 Komunikim dhe zhvillim i grupeve rinore -Trajnime

Pasi që në qender rinore kemi shumë të rinjë që janë aktiv dhe dëshirojnë të kontribojnë në qytetin e tyre dhe grupet e të rinjëve kohë pas kohe janë aktiv në aktivitetet e qendrës rinore. Vullnetarja europiane nga Estonia ka menaxhuar përgaditjen e 4 trajnimeve për ngritjen e kapacitetve të grupeve rinore, në komunikim dhe punë grupore. Në këto trajnime kanë marrur pjesë antarët e qendrës Rinore dhe të rinjë të shkollave të mesme të qytetit të Klinës.
Çdo të premte të rinjët moren pjesë në sesione të trajnimit dhe një numër i madh të rinjësh patën mundësi që të marrin njohuri të cilat do të ju shërbenin për të punuar në grupe dhe gjithashtu për të inicuar aktivitete të cilat do të ndikonin në zhvillim të komunitetit të Klinës. Trajnimet kanë zgjatur në periudhë një mujore dhe janë zhvilluar dhe udhëhequr nga Vullnetarja Evropiane Cairit Eit-Evs Estonia

Klinë, 02 mars 2016

2.3 “World coffee day”

Forumi rinor është zhvilluar me 25 shkurt 2016 në Qendren Rinore Ardhmeria sipas metodes së edukimit jo-formal është përdorur termi “Dita e kafës boterore”. Të rinjët e moshes 15-23 vjeq patën mundësi të diskutojnë tema të ndryshme: Edukimi, Sporti dhe kultura, Mjedisi, Shoqëria civile dhe Mirëqenia sociale me ekspert nga të gjitha këto fusha. Si rezultat, problemet kryesore të të gjitha fushave janë prekur dhe shtjellur nga të rinjët.

25 Shkurt 2016

2.4 Mbrëmje ndërkulturore

Për të mirëpritur vullnetaren Lituaneze EVS në Klinë dhe për të shkëmbyer kulturen tonë, të rinjët e Qendres Rinore organizuan një darkë mikëpritëse dhe secili prej tyre ka sjellur ushqime tradicionale shqiptare dhe gjithashtu kanë prezantuar kulturen tonë Kosovare, në mënyrë që vullnetarja evropiane të njihet me kulturen tonë dhe në të njohim ushqimet e tradites lituaneze të cilat vullnetarja kishte përgaditur dhe sjellur nga Lituania. Të rinjët kaluan një mbrëmje të mirë ndërkulturore dhe gjithashtu u argëtuan në një mjedis të mirë rinor.

18 mars 2016

2.5 Dita botërore e Ujit.

Me 22 mars të rinjët e Klinës shënuan ditën ndërkombëtare të ujit. Grupi i qendrës “Klina youth chapter” organizoi ligjerata dhe marsh për të vetëdijësuar qytetaret e Klinës për rëndësinë e ujit.

Ligjerata është zhvilluar në shkollën fillore “Ismet Raci” ku moren pjesë fëmijët e moshes 12-14 vjeç, ligjerues ishin dy vullnetarë të moshes 15-16 vjeç që ishin përgaditur për të mësuar fëmijët tjerë për rëndësin e ujit.

Marshi në qytet: Në marsh kanë marrë pjesë fëmijët e moshes 7-8 vjeç dhe janë udhëhequr nga vullnetarët e qendës rinore dhe gjithashtu janë përcjellur nga mësuesit e fëmijëve nëpër rrugët e qendrës së qytetit.

Këto ishin disa aktivitete vetëdijësuese dhe edukuese për fëmijët dhe qytetarët tonë në menyrë që të japim një mesazh për rëndësin e ujit në jetën tonë.

22 mars 2016

2.8 Dita Botërore e Tokës/Global youth Service day

Për të shënuar diten Botërore të Tokës dhe për të vetëdijësuar qytetarët tonë të Klinës grupi rinor nga Qendra Ardhmeria organizoi aktivitete gjatë tërë javes, në mënyrë që të senzibilizoj qytetarët për realitetin e natyrës në Klinë.

Gjatë tërë javes grupi rinor kontaktoi shumë të rinjë tjerë dhe angazhuan edhe këshillat rinor të dy shkollave fillore për të vizituar natyrën e qytetit të Klinës dhe ambientit që na rrethon. Gjatë vizitave të tyre të rinjët fotografuan natyrën e stërmbushur me mbeturina dhe në veqanti parkun e Klinës i cili është në gjendje të mjerueshme.

Të rinjët duke e parë shumë të nevojshme për të ekspozuar këtë natyrë të ndotur dhe të pambrojtur nga askush, ekspozuan fotot në dy shkolla fillore si: " Ismet Raci" dhe "Motrat Qiriazi" gjithashtu ekspozita e fotove është bërë edhe në shesh të Qytetit, të rinjët patën mundësi të anketojnë edhe qytetarët dhe kalimtarët e rastit në mënyrë që të marrin edhe mendimet e tyre për realitetin e natyres së ndotur në Klinë.

Qëllimi i inciatives ishte që të rinjët të japin një mesazh senzibilizues tek qytetarët për mbrojtjen e ambientit dhe të vlerësojmë pasurinë e natyrës që kemi në Qytetin e Klinës.

Ipmlementuar nga Grupi Rinor- Klina Youth Chapter, 22 Prill 2016

Address: str.Abedin Rexha, 32000 Klinë –Kosovo, tel:+383 (0) 38 748 274,
Web:www.ycardhmeria.com, email: info@ycardhmeria.com, youthcenter.kline@hotmail.com

2.9 Pastrimi i qytetit.

Në kuader të Iniciatives të pastrojmë Kosoven grupi i të rejave të qendres Rinore pastruan parkun dhe bregun e lumit Klina, edhe pse Komuna e Klinës mori një inciative për të pastruar qytetin dhe bëri ndarjen e zonave së pastrimit, ne si qender rinore morem përsiper që ta pastrojm parkun dhe bregun e lumit Klina.

24 Maj 2016

2.10 Dita botërore kundër duhanit

Për ditën botërore kunder duhanit të rinjët e qendres rinore "ARDHMERIA" kanë zhvilluar këtë aktivitet:

Ligjeratë vetëdijësuese për pasojat e përdorimit të duhanit. Ligjerata është mbajtur në shkollën fillore "Motrat Qiriazi" në Klinë.
Ligjerata vetëdijësuese është udhëhequr nga Peer-Edukatoret: Armir Prenaj dhe Venera Bojaj. Kjo inciativë është zhvilluar për shkak të pasojave që shkakton pirja e duhanit, fenomen ky shumë i pranishëm tek të rinjët .
Në këtë ligjeratë moren pjesë 23 nxënës të klases së VIII .Fëmijët u ndan të kënaqur nga ligjerata dhe u hapen pyetje të shumta dhe ishin shumë kurioz për pasojat që shkakton pirja e duhanit.

Raportoi: Venera Bojaj, datë 30.05.2016, Klinë.

2.11 Festa 1 Qershorit "Talentët e Vegjël"

Me 1 Qershor 2016 organizuam ngjarjen kulturore" Talentët e Vegjël" me qellim që të bashkojmë të gjithë talentët e vegjël të komunës së Klinës, në këtë ngjarje kulturore moren pjesë të rinjët nga organizatat rinore dhe nga shkollat Fillore dhe kjo iniciativ është përkrahur nga Drejtoria e Kultures, Rinisë dhe Sportit.

Një numër i madh të rinjësh të moshes 7-12 vjeç përformuan me pika këndimi, vallëzimi humori dhe vjersha ku prej tyre u shpërblyen disa pika. Ishte kënaqësi që në festën e fëmijëve të shihje fytyra të gëzuara dhe shumë të lumtura.

Qendra Rinore falenderon të gjithë qytetarët e komunës së Klinës, shkollat fillore të komunes së Klinës dhe Karitas Umbria për pjesëmarrje.

1 Qershor 2016

2.12 Workshop Edukativ (I)

Ky aktivitet është organizuar me qellim që ti rrisim kapacitetet e të rinjëve për të përgaditur një CV dhe për të mësuar se si ta paraqesin veten e tyre në mënyrën me të mirë të duhur në çdo aplikim të mundshëm. Nga ky workshop përfituan 18 të rinjë të moshës 15-18 Vjeç. Workshopi është udhëhequr nga vullnetari PCV Andrew J.Bivins dhe asistuar nga studentja Florida Gashi.

Qendra Rinore Ardhmeria falenderon vullnetarët e jashtëm që përkrahen të rinjët e Klinës.

06 Qershor 2016

2.13 Gjysëm maratona Vrapimit 2016

Me 22 Qershor vullnetarët e Qendres Rinore Ardhmeria organizuan maratonë vrapimi për fëmijë të moshes 7-8 vjeqë dhe moshen 9-10 vjeçë. Aktiviteti i sportit për fëmijë është zhvilluar në fushen e futbollit "18 Qershori" në Klinë dhe moren pjesë 40 fëmijë, një numër i vogël fëmijësh patën mundësi të kalojnë disa orë sporti në natyrë.

Qendra Rinore falenderon fëmijët që moren pjesë si dhe Sektorin e Sportit z.Xhafer Ademin për bashkëpunim dhe në përkrahjen e tij në aktivitete sportive.

22 Qershor 2016, Klinë

2.14 Shfaqje teatrale "Borëbardha dhe 7 xhuxhat"

Gjatë muajit korrik Qendra Rinore ka organizuar aktivitete verore për fëmijë të moshave 6-12 vjeç, është punuar në grupe ku jemi bazuar në moshen e fëmijëve.

Aktivitetet janë zhvilluar çdo ditë me tematika të ndryshme dhe puntori kreative të ndryshme, gjithashtu secilli workshop (grup) është udhëhequr nga dy vullnetarë të qendrës rinore.

Aktivitetet verore kanë zgjatur 1 muaj dhe çdo ditë është zhvilluar një workshop, secili workshop kishte një lidhshmëri me workshopin tjetër pasi një grup ka punuar kostumet kreative, një grup ka përgaditur dekorimet kreative, një grup ka përgaditur lojërat, një grup ka përgaditur koreografi muzikore dhe një grup ka përgaditur rolet dhe zhvillimin e shfaqjes. Pas përfundimit te të gjitha aktiviteteve verore si rezultat zhvilluam shfaqjen teatrale "Borëbardha dhe 7 xhuxhat" në Shtëpinë e Kulturës "Jehona Dukagjinit" në Klinë.

Të gjithë fëmijët që përformuan për hërë të parë në skenë ishin shumë të lumtur dhe ndiheshin shumë krenar për përformancen e tyre.

Qendra Rinore Ardhmeria falenderon të gjithë vullnetarët që punuan si dhe fëmijët që ishin pjesë e programit tonë veror dhe mahnitës në qytetin tonë.

Korrik 2016, Klinë

2.15 Workshop Edukativ (II)

Me 12 shtator 2016 arritem që të vazhdojm pjesën e dytë të trajnimit edukativ për të rinjë dhe gjithashtu është zhvilluar workshopi me temen: Si të shkruajm një letër motivuese, pasi që për të gjitha aplikimet ne programet e avancuara të rinjët duhet të kenë njohuri për të përgaditur një letër motivuese.

Nga ky aktivitet përfituan 10 të rinjë të moshës 15-18 vjeq nga Klina. Trajnimi është udhëhequr nga vullnetari Andrew J.Bivins "Peace Corps" dhe asistuar nga studentja Florida Gashi.

12 Shtator 2016

2.16 Halloween n'Klinë "Trick or Treat" 2016

Halloween n'Klinë "Trick or Treat" 2016 ishte një sukses në shumë mënyra të këtij viti. Si një qendër rinore e fokusuar në ndërtimin e kapaciteteve të të rinjëve në Klinë, ne kemi qenë në gjendje të organozojmë vullnetarët e qendrës rinore për të krijuar një ngjarje për fëmijët në komunën e Klinës. Ata diskutuan, planifikuan dhe përgatiten një event për fëmijët e vegjël. Pastaj, pas disa ditëve të planifikimit dhe përgatitjes, vullnetarët tonë të rinjtë ishin në gjëndje për të udhëhequr dhe për të lehtësuar një ngjarje në shkallë të madhe që përfshin 450 fëmijë dhe familjar të tyre, për një mbrëmje të angazhimit interaktive. Arritem që eventi të dukej si një festival ndërkombëtar dhe multi-kulturore për natën e Halloëeen. Në mënyrë që të angazhojm më shumë komunitetin apo qytetaret e Klinës, ne vendosem për të angazhuar bizneset lokale që të sponzorizojn ngjarjen tonë. Ne jemi mirënjohës për bizneset lokale si: Blinipharm Barnatore, Dorina Pasticeria, Te Rrethi Restorant, Euro Bar Kafe, Pizza Fresh, Qyteza dhe një donacion privat nga familja Childers për mbështetjen e tyre të mrekullueshme dhe donacionet financiare. Të gjitha kontributet e tyre të na mundësuan për të ofruar çmime dhe lojra së bashku me pikturë fytyrë dhe duke e bërë maskë. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport po ashtu ka kontribuar në masë të madhe, duke siguruar argëtim të mëtejshëm me stilet muzikore të DJ Poni, si dhe materiale të shumta për të ndërtuar lojrat tona.

Bazuar në të dhënat fillestare të dhënave, mund të vini re se kemi pasur një pjesëmarrje prej mbi 450 njerëz nga Komuniteti. Numrat tonë janë bazuar në biletat dhe çmimin e sistemit të vënë në vend për ngjarjet e mbrëmjes. Përdorimi i përgjithshëm i biletave,

çmimet dhe shpërblimet na siguronin numrin e pjesëmarrjes që ishte në rangun e 500-600 të pranishm. Duke përdorur modelin e këtij viti, ne kemi përshtatur një sistem të ri për të monitoruar në terren dhe frekuentimin për ngjarjet në të ardhmen për t'i bërë ato më të mëdha dhe më interaktive. Ne falënderojm të gjithë sponsorët tanë, pjesëmarrësit tanë dhe të pranishmit që bëren këtë ngjarje Halloween këtë vit të suksesshem.

31 Tetor 2016

2.17 Dita Ndërkombetare e Drejtave të fëmijëve.

Për nder të 20 Nëntorit Ditës ndërkombëtare të drejtave të fëmijëve Qendra Rinore ka organizuar një Workshop me 10 fëmijë të moshës 7-10 Vjeqë .

Fëmijët në këtë aktivitet kanë pasur për detyrë të ngjyrosin punime sipas dëshirës se tyre, punimet kishin domethënie për të drejtat e fëmijëve si:

Të drejtat Kombëtare, të drejtat në familje, të drejtën e lojës, të drejtën e shkollimit, të drejtën e shëndetit, të drejtën e mbrojtjes, të drejtën e fesë etj.Me anë të vizatimit fëmijët I kanë mësuar dhe kuptuar më mirë këto të drejta për të cilat duhet ti praktikojm në jetën e përditshme. Në sesionin e fundit të këtij aktiviteti secili fëmijë ka përshkruar punimin e vet dhe domethenien e asaj të drejte pse ai ose ajo ka përzgjedh. Në përfundim të gjithë fëmijët kanë marrur fletushka për ti lexuar me familjët ë tyre dhe se bashku me prinder të bisedojn për të drejtat e fëmijëve dhe festës Së 20 Nëntorit. Aktiviteti ka zgjatur dy orë dhe është lehtësuar nga stafi I qendres Rinore..

21 Nëntor 2016

2.18 Dita Flamurit Shqiptar

Për nder të festës së 28 Nëntorit të rinjët e Qendres Rinore kanë punuar me një grup fëmijësh dhe së bashku kanë përgaditur një shfaqje teatrale për ditën e Flamurit kombëtar në Klinë.

Shfaqja u realizua me 29 Nëntor dhe fëmijët me përformancen e tyre e bën një skenë të bukur dhe madhështore ku secili fëmijë ishte shume i lumtur sepse I'u dha mundësia të

përformojn para publikut dhe prindërve të tyre. Gjithashtu shohim si rezultat interesimin e fëmijëve për të qënë pjesë e aktrimit dhe aktiviteteve kulturore.

Shfaqja është realizuar në Shtepin e Kulturës në Klinë

Punuar/Venera Bojaj, 29 Nëntor 2016

1.18 Dita Botërore kunder HIV/ AIDS

Grupi Rinor "Klina Youth Chapter" zhvilloi aktivitet 1 ditor me qëllim të vetëdijësimit të të rinjëve për pasojat e HIV/Aids dhe sëmundjeve SST, ky aktivitet është zhvilluar në objektin e Qendres "Ardhmeria".
Antaret e Grupit organizuan nje ligjeratë për një grup të rinjësh të moshës 14-16 vjeqë si dhe kanë shfaqur një dokumentar që kishte për qëllim vetëdijësimin e pasojave të shkaktuara si dhe këshillat e experteve botëror. Mbrenda grupit është krijuar një ambient i mirë ku të rinjët mund të diskutonin mesvete dhe u ndien të hapur për të ndarë opinionet e tyre rreth Sëmundjeve transmetuese.

Pas përfundimit të aktivitetit në qytet grupi rinor ka shpërndarë broshura për këshillim dhe vetëdijësim të të rinjëve.

Aktiviteti është lehtësuar nga vullnetarja Doruntinë Doçi, e cila ishte përkrahur gjithashtu nga të rinjët tjerë të Grupit Rinor,

Punuar/Klina Youth chapter, 01 Djetor 2016.

2.19 Aktivitetet Humanitare:

***Mbledhje fondeve në biznese* private**-të rinjët kanë shprehur të fillojn aktivitetet humanitare duke filluar me mbledhjen e fondeve në bizneset private dhe të shohin për së afërti se sa bizneset private japin kontributin e tyre për familjët e varfëra. Të rinjët kanë mbledhur fonde nga këto biznese dhe gjithashtu kanë krijuar një listë të bizneseve që kanë kontribuar në këtë iniciative. Grupi që realizoi këtë iniciative ishte shumë I sfiduar por gjithashtu edhe ishin të lumtur për arritjet e tyre.

15-20 Dhjetor 2016

Shitje të kartolinave-të rinjët e Qendres Rinore janë organizuar që dy javë me radhë të punojn kartolina dhe gjëra dekoruese festive, secili antar ka punuar dy orë në Qender Rinore. Gjatë këtyre ditëve të ftofta dimërore prania e një numëri prej 20 të rinjëve ishte shumë active, paten një rezultat të mirë sepse arriten të përdorin material kreativ dhe reciklues për të punuar kartolina, çanta, Betlehem të drurit dhe gjërat dekoruese për festa.

Të rinjët kanë arritur që ti shesin punimet e tyre me 16 dhjetor në qender të qytetit dhe të gjitha punimet janë shitur dhe shumë qytetar kanë përgezuar këtë iniciative.

16 Dhjetor 2016

Koncert Humanitar

Me 17 Dhjetor 2016 Grupi Rinor vendosi të organizoi një Koncert Humanitar me qëllim të mbledhjes së fondit për familjët e varfëra. Pasi që ishte Koncert humanitar shumë muzikant të Klinës ftuan miqt e tyre nga Peja dhe Bende Muzikore nga Prizreni për të përformuar dhe shfaqur ndjenjën e humanitetit për qytetaret e Klinës.

Pasi që i tërë organizimi ishte shumë i mirë megjithatë ne si Qender Rinore nuk ishim shumë të kënaqur me prezencen e qytetarve të Klinës pasi që ishtë një numër shumë i vogël i publikut! çdo ditë po verëhet një mospjesëmarrje e qytetareve dhe familjarëve në aktivitete të Kultures në qytetin e Klinës.

Edhe Përkunder salles së ftoftë të Shtepisë së Kulturës këngëtaret e rinjë krijuan një ambient dhe një atmosferë argetuese dhe kulturore.

Qendra Rinore Ardhmeria përgezon Grupin Rinor Klina Youth chapter dhe falenderon këngetaret: Ardian Gojani, Erion Palucaj, Betina Millaku, Anita Selitaj, Bleona Leka, Albana Nila, Gentrit Mrasoraj dhe Bendin muzikor nga Shkolla Loyola-Prizren për përformancen dhe përkrahjen e tyre.

17 dhjetor 2016

Shpërndarje të ndihmave Në javen e fundit të dhjetorit dhe pas përmbledhjes së tërë fondit të krijuar Qendra Rinore Ardhmeria ka qene e gatshme për të shpërndare ndihma në 6 familje të komunës së Klinës.

Disa familjare kanë sjellur veshmbathjet e tyre në zyret e qendres dhe të rinjët e Qendres kanë përgaditur pakot e ndihmave me ushqim, veshmbathje dhe dhurata për fëmijë dhe të gjitha këto janë shpërndare tek familjët që kanë nevojë për një përkrahje dhe jetojn në kushte të veshtira ekonomike. Transporti I shpërndarjes së ndihmave është mundësuar nga komuna e Klinës dhe disa të rinjëve.

Qëllimi I realizimit të këtij aktiviteti është që të zhvillojm një shpirt të humanitetit tek të rinjët tonë dhe te ngrisim një vetdijësim tek qytetaret tonë, gjithashtu si qëllim ishte gëzimi i familjareve, fytyrat e qeshura të fëmijëve që me një punë të përbashket arritem që ti gëzojm duke përfishirë të gjithë qytetaret e Klinës.

Bashkëpuntor: *Grupi Rinor "Klina youth chapter" Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Bizneset Private.*

Dhjetor 2016, Klinë

2.19 Mbrëmje për Krishtlindje dhe Vitin e Ri

Për të përmbledhur dhe reflektuar të gjitha aktivitet gjatë vitit Qender Rinore Ardhmeria organizoi një mbrëmje për të gjithë antaret e saj dhe vullnetaret që ishin gjatë tërë vitit aktiv, festuam së bashku dhe kujtuam aktivitetet e realizuara të vitit 2016 me një video që përmbledhi fotografit e tërë punës vjetor. Mbrëmja përmbyllese u percjell me lojra dhe muzik për të rinjë. Ceremonia u përmbyll me shpërndarje të Mirënjohjeve për antaret që ishin aktiv gjatë vitit 2016 si dhe me dhurata nga vet të rinjët.

Gëzuar Viti ri 2017

3 . BASHKËPUNIMET / PARTNERSHIPS

3.1 Cuprija Caravan Kamp 2016

Çdo dy vite organizohet kampi i trashëgimisë natyrore i quajtur " Cuprija Caravan Camp", Ky kamp është organizuar nga organizata skautiste e Luxemburgut dhe Qendra Rinore Ardhmeria është një nder partnerët pjesëmarres në këtë kamp. Ky është projekti I tretë (3) që Qendra Rinore bashkëpunon me organizaten Scout dhe l'u japim mundësi të rinjëve Kosovar të parteciojn në këtë kamp 21 Ditor.
Në këtë vit moren pjesë 8-të të rinjë nga Kosova dhe pjesëmarrësit tjerë ishin nga luxemburgu dhe Bosnia.

Një numër prej 60 të rinjëve prej tri(3) vendeve të ndryshme patën mundësi për të punuar së bashku në kampin veror në Bosne & Hercegovinë për 21 ditë, ishte një mundësi për të rinjët që të shkëmbejn kulturat e tri vendeve të ndryshme dhe të mësojn nga njëri tjetri. Kampi ishte i organizuar në at menyrë që të rinjët të punojn por njëkohësisht edhe të vizitojn qytet dhe vendet tjera të Ballkanit si: Bosnia, Kroacia dhe bregetin e Malit zi.
Implemenuar prej 17^{të} Korriku deri me 6^{të} Gusht *2016 , në Rakovic-Bosne dhe Hercegovine.*

3.2 Konferenca për lider Rinor-MCW New York

Një nder partneret e rinjë që kishim këtë vit ishte MCW që zhvillon programin për lidership të rinjë dhe ju mundëson të rinjëve botëror për tu përgaditur dhe zhvilluar kapacitetet për të udhëhequr dhe inicuar ndryshimeve pozitive në vendin ku jetojn. Organizata MCW identifikon të rinjët që kanë potencial për të qënë udhëheqës të një komuniteti të caktuar. Konferenca rinore l'u mundeson një zhvillim për të kuptuar më të thellë për qështjet sociale dhe ndryshimin e tyre, aftësimin e njohurive, rrjetizim dhe vetbesim në rastin kur këta pjesëmarres të kthehen në vendin e tyre të kthehen me njohuri dhe vetbesim për të shërbyer në vendin e vet si Lider të mobilizuar botërorë. Këtë vit nga kjo konfernecë botërore kanë përfituar tre të rinjë nga Klina.

Konferenca Rinore është zhvilluar në Manhaten dhe Vermont-SHBA, prej 27^{të} korrik deri 03 Gusht 2016

3.3 Trajnim për puntor rinor "Mediat Sociale & aktivizimi rinisë dhe komunitetit "

Trajnimi është organizuar me qellim të rritjes së kapaciteteve të organizatave rinore për të përdor mediat sociale dhe të forcohet një bashkëpunim në mes të partnereve Evropian. Trajnimi është organizuar nga organizata Arci Strauss në qytetin Nicolasi dhe ka zgjatur tetë (8)ditë, nga qendra Ardhmeria moren pjesë dy puntor rinor që ishin pjesë e 16-të organizatave komunitare nga 16 vendet e ndryshme europiane.

Implementuar në Nicolasi-Italy prej 05 -12 Tetor 2016

3.4 KMUNA, Kosovo Model United Nations –Association

KMUNa, Model I Kombëve të Bashkuara në Kosovë është ndërtuar si model i Klubeve të kombëve të bashkuara në tërë botën. KMUNa është dizajnuar që t'iu jep mundësi të rinjëve për të zgjeruar kapacitetet e tyre në hulumtim, debat, procedura parlamentare, draftim të letrave hulumtuese dhe zhvillimin e të folurit në publik. Grupet e të rinjëve janë krijuar në shtete me temë të caktuar. Secili grup duhet të hulumtoj në shtetin përkatës, pikëpamjet e një vendi dhe të përcakohet në një temë apo qështje të caktuar. Qellimi i Grupit KMUNa është që t'iu jep të rinjëve të Kosovës një pikëpamje diplomatike për temen duke zgjeruar të menduarit e tyre kritik dhe aftësitë e të folurit në publik.
Pas 15 sesioneve të zhvilluara, grupet nga tërë bota do të ftohen në konferencen finale "Model United Nations" në Maqedoni. Në këtë konferencë do të paraqesin opinionin për shtetin e vet në një dëbat publik. Për hërë të parë do të kemi një grup të rinjësh edhe nga Klina.

Grupi KMUNa në Klinë ka filluar në Tetor 2016 dhe do të zhvilloj sesionet në Qender Rinore deri në maj 2017, Grupi prej 15 të rinjëve 15-18 vjeqë është duke u lehtësuar nga Vullnetari PCV Andrew B. James dhe Florida Gashi.

STATISTIKAT /PERFITUESIT

TABELA 1: Përfituesit e Qendres Rinore në bazë të Etnicitetit					
Periudha	Shqiptar	Serb	RAE	Tjera	Total
01/1/2016-30/12/2016	365	0	0	2	367
%	99.46	0.00	0.00	0.54	100.00



TABELA 2: Përfituesit e Qendres Rinore në bazë të Origjines			
Periudha	Rural	Urban	Total
1/1/2016-31/12/2016	95	271	366
%	25.96	74.04	100.00



Address: str.Abedin Rexha, 32000 Klinë –Kosovo, tel:+383 (0) 38 748 274,
Web:www.ycardhmeria.com, email: info@ycardhmeria.com, youthcenter.kline@hotmail.com

TABLE 3: PËRFITUESIT NË BAZË TË MOSHËS						
Periudha	<15	15-18	19-21	22-24	>24	Total
1/1/2016-31/12/16	246	110	8	1	2	367
%	67.03	29.97	2.18	0.27	0.54	100.00

TABLE 4: PËRFITUESIT NË BAZË TË GJINISË			
Periudha	Mashkull	Femër	Total
1/1/2016-31/12/16	135	231	366
%	36.89	63.11	100.00